LIGJ
Nr.9757, datë 21.6.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE) PËR SIGURIMIN E MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS, PËR REALIZIMIN E STËRVITJEVE TË BASHKËPUNIMIT LONGBOW DHE LANCER, 2007"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) për sigurimin e mbështetjes së shtetit pritës, për realizimin e stërvitjeve të bashkëpunimit LONGBOW dhe LANCER, 2007".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5378, datë 26.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPË (SHAPE) NË LIDHJE ME SIGURIMIN E MBËSHTETJES SË SHTETIT PRITËS PËR REALIZIMIN E STËRVITJEVE TË BASHKËPUNIMIT LONGBOW 2007 DHE LANCER 2007

HYRJE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), këtu e tutje të quajtura Palë,

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut, të datës 4 prill 1949, dhe në veçanti nenin 3 të saj;

- *duke pasur parasysh* Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të lëshuar prej kryetarëve të shteteve dhe qeverive pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumenti Kuadër), të 10 janarit 1994;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Marrëveshjes midis Shteteve Palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe në lidhje me Statusin e Forcave të Tyre (PfP SOFA) të datës 19 qershor 1951, përfshirë edhe Protokollin Shtesë të kësaj Marrëveshjeje, të datës 19 qershor 1995;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Marrëveshjes ndërmjet palëve pjesëmarrëse në Traktatin e Atlantikut të Veriut në lidhje me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1951;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Protokollit mbi Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare, hartuar në vijim të Traktatit të Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit) të datës 28 gusht 1952;

- *duke pasur parasysh* dispozitat e Protokollit të Mëtejshëm Shtesë mbi Marrëveshjen midis Shteteve Anëtare të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në PfP SOFA

(Protokoll i Mëtejshëm Shtesë) i datës 19 dhjetor 1997;

- *duke pasur parasysh* konceptin e shpërndarjes së forcave të NATO-s dhe forcave të koalicionit nën komandën dhe kontrollin e NATO-s në ose përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim planifikimin dhe realizimin e stërvitjeve COLW07 dhe COLR07;

- *duke pasur parasysh* konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve të parashikuara që të zhvillohen me NATO-n, PfP dhe forca të tjera të udhëhequra nga NATO-ja;

- *dhe duke marrë në konsideratë* nevojat e Republikës së Shqipërisë, e cila këtu e tutje quhet vendi pritës dhe nevojat e SHAPE, HQ SACT, këtu e tutje referuar si Komanda Strategjike, Palët kanë arritur në mirëkuptimin e mëposhtëm:

SEKSIONI 1
PËRCAKTIME

Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe dokumenteve të tij plotësuese, aplikohen përcaktimet e mëposhtme:

1.1 Forcat: Të gjithë komponentët e forcave të udhëhequra nga NATO, përfshirë këtu edhe të gjithë personelin, kafshët, materialet dhe ushqimet, bashkë me përbërësit civilë të këtyre forcave, siç është përcaktuar në NATO SOFA, Protokollin e Parisit dhe homologët e PfP-së. Forcat e udhëhequra nga NATO gjithashtu përfshijnë çdo forcë ose personel prej vendeve të Dialogut të Mesdheut, si dhe vendet e Iniciativës së Bashkëpunimit të Stambollit. Përcaktimi gjithashtu përfshin të gjitha anijet, avionët, automjetet, pajisjet, furnizimet, rezervat dhe armatimet, si dhe të gjitha burimet e 1ëvizjeve detare e ajrore, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, përfshirë dhe kontraktuesit shpërndarës ose mbështetës të forcave.

1.2 Operacionet e NATO-s: Veprimet ushtarake që përmbajnë stërvitje apo misione ushtarake strategjike, taktike, shërbimi, trajnuese, të zhvilluara nga forcat; procesin e zhvillimit të luftimit, përfshirë sulmin, lëvizjen, furnizimin dhe manovrat e nevojshme për arritjen e objektivave të çdo beteje ose fushate.

1.3 Komandanti i NATO-s: Komandant ushtarak në hallkat komanduese të NATO-s.

1.4 Organizatat e NATO-s: Shtabe dhe njësi forcash të organizuara nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 Shtabet ushtarake ndërkombëtare: Shtabet ushtarake ndërkombëtare në strukturat përbërëse komanduese të NATO-s.

Këtu përfshihen dhe ekipet dhe njësitë e përkohshme të këtyre shtabeve.

1.6 Shtabet kombëtare: Shtabet e forcave kombëtare nën kontrollin dhe komandën e NATO-s.

1.7 Shtabet shumëkombëshe: Shtabe me personel të përbërë nga më shumë se një shtet, të formuara në bazë të marrëveshjes mes shteteve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.8 Vendet dërguese (VD): Ato shtete dhe shtabe ose elementet e tyre të dërguara jashtë territorit të vendeve të tyre në territorin e vendit pritës, për të mbështetur operacionet e NATO-s.

1.9 Vendi pritës (VP): Republika e Shqipërisë.

1.10 Komandantët strategjikë ose komandat: Komandanti Suprem i Forcave të Aleancës në Europë, shtabi i së cilës është SHAPE.

1.11 Mbështetja e vendit pritës (MVP): Asistencë civile dhe ushtarake që i jepet nga një vend pritës forcave të aleatëve dhe organizatave në kohë paqeje, emergjence, krize dhe konflikti, dhe strukturat të cilat janë të vendosura, që operojnë apo janë transit në territorin e vendit pritës, në ujërat territoriale apo hapësirën ajrore të tij.

1.12 Forca mbrojtëse (FM): Të gjitha masat e marra dhe mënyrat e përdorura për të minimizuar cenueshmërinë e personelit, lehtësirat, pajisjet dhe operacionet kundrejt çdo rreziku dhe në çdo situatë për të mbrojtur lirinë e veprimit dhe efektivitetin operacional të forcave.

1.13 Shpenzimet: Shpenzimet të cilat lidhen me vendosjen, mbështetjen dhe mbajtjen e shtabeve kombëtare, shumëkombëshe ose shtabet ndërkombëtare, forcat ose organizatat e NATO-s. Për qëllim të këtij Memorandumi Mirëkuptimi dhe dokumenteve që do ta pasojnë:

a) Shpenzimet e përbashkëta të NATO-s. Këto shpenzime të cilat janë pranuar që më parë si përgjegjësi kolektive e Aleancës.

b) Shpenzimet e përbashkëta. Për të cilat është rënë dakord më parë të jenë nën përgjegjësinë e përbashkët të më shumë se një kombi. Rregullimet për këto shpenzime zakonisht bazohen në një formulë të detajuar në marrëveshjen teknike përkatëse dhe/ose në rregullimet e përbashkëta të implementimit.

c) Kostoja kombëtare direkte. Shpenzimet që konsiderohen si përgjegjësi e një vendi dërgues (VD)

të vetëm.

1.14 Fondi i përbashkët i NATO-s: Fondi i siguruar nga vendet e NATO-s dhe i livruar me miratim nëpërmjet buxhetit të NATO-s për shpenzimet e përbashkëta, të shkaktuara gjatë zhvillimit të operacioneve ose stërvitjeve përkatëse.

1.15 Notë pjesëmarrjeje (NP): Dokumenti që tregon qëllimin e (VD)-së për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij MOU për një operacion të specifikuar të udhëhequr nga NATO.

1.16 Deklaratë qëllimi (DQ): Dokumenti që shpreh qëllimin e VD-së për të marrë pjesë në përgatitjet mbi mbështetjen e vendit pritës sipas dispozitave të këtij MOU, por i kushtëzuar nga kufizime specifike. Vendi pritës do të konfirmojë nëse kufizimet janë të pranueshme apo jo për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës.

1.17 Marrëveshja teknike (MT): Përgatitje teknike dypalëshe që ndiqet për një operacion specifik të NATO-s. Detajon përgjegjësitë dhe procedurat për sigurimin e mbështetjes së vendit pritës kundrejt komandantit të NATO-s dhe vendit/ve dërguese.

1.18 Marrëveshja e Përbashkët e Zbatimit: Marrëveshja bilaterale që ndiqet, e cila përcakton angazhimet mes palëve nënshkruese në lidhje me sigurimin dhe marrjen e mbështetjes së vendit pritës. Marrëveshja përfshin informacion të detajuar mbi ndihmën e kërkuar dhe të ofruar, përcakton procedura specifike mbi vendndodhjen e implementimit dhe afatet e rimbursimit ose pagimit.

1.19 Komiteti Drejtues i Përbashkët mbi Mbështetjen e Vendit Pritës: Komiteti i ngritur për këtë rast dhe i bashkëkryesuar nga vendi pritës dhe komandanti i NATO-s. Komiteti i përbërë nga përfaqësues të autorizuar nga të gjitha vendet dërguese, vendi pritës dhe komandanti i NATO-s do të mblidhen për të koordinuar përgatitjet zgjeruese të nevojshme që kanë të bëjnë me mbështetjen e vendit pritës, siç janë marrëveshja teknike dhe marrëveshjet e përbashkëta të zbatimit, sipas rastit.

1.20 Vendqëndrimet operacionale: Vendqëndrime të lokalizuara në territorin e vendit pritës, me qëllim mbështetjen operacionale dhe/ose logjistike për forcat në operacionet e drejtuara nga NATO-ja. Këto vendqëndrime janë detashmente të komandës strategjike nën komandën dhe kontrollin e komandantit të NATO-s.

1.21 Territori: Nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë tokën, hapësirën ajrore dhe ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë.

1.22 Stërvitjet: Në përputhje me Programin e NATO-s për Stërvitjen dhe Trajnimin Ushtarak, seria e stërvitjeve të përbashkëta për 2007 të quajtura Longbow 2007 (COLW 07) dhe Lancer 2007 (COLR 07), të cilat do të zhvillohen në Tiranë, Shqipëri, gjatë periudhës 1-30 tetor 2007, këtu e tutje referuar si “Stërvitjet”.

1.23 Me përjashtim të rasteve kur kuptimi specifikohet në këtë MOU, aplikohet Fjalori i Termave dhe Përkufizimeve të NATO-s (AAP-6).

SEKSIONI 2
QËLLIMI

2.1 Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është të përcaktojë politikat dhe procedurat për krijimin e vendqëndrimeve operacionale dhe sigurimin e mbështetjes së vendit pritës ndaj forcave të NATO-s gjatë planifikimit, ekzekutimit dhe ridislokimit të stërvitjeve.

2.2 Kjo Marrëveshje Mirëkuptimi dhe dokumentet që dalin prej saj kanë për qëllim krijimin e një bazë planifikimi për autoritetin e duhur të vendit pritës dhe komandantin e NATO-s, në pritje të përgatitjeve për mbështetjen e vendit pritës gjatë stërvitjeve.

SEKSIONI 3
SHTRIRJA DHE ANGAZHIMET E PËRGJITHSHME

3.1 Dispozitat e NATO-s ose të PfP SOFA, Protokollit të Parisit dhe Protokollit Shtesë, dhe çdo marrëveshje tjetër në fuqi mes komandave strategjike të NATO-s dhe vendeve pritëse do të aplikohen gjatë stërvitjeve.

3.2 Vendi pritës njeh vendqëndrimet operacionale të krijuara për implementimin e këtij Memorandumi si detashmente të komandës strategjike dhe veprimtaritë e këtyre detashmenteve të jenë sipërmarrje të komandës strategjike. Vendqëndrimet që do të krijohen, do të përcaktohen në dokumentet vijuese. Komanda dhe kontrolli i përgatitjeve do të vendosen në planet e zbatueshme operacionale ose stërvitore.

3.3 Ky Memorandum Mirëkuptimi do të jetë në përputhje me politikën dhe doktrinën e NATO-s dhe siguron një strukturë dhe përgatitje gjithëpërfshirëse për (MVP) mbështetjen e vendit pritës.

3.4 Vendi pritës do t'u sigurojë mbështetje me kapacitetin e tij të plotë forcave të dislokuara për stërvitje, në varësi të disponueshmërisë dhe brenda kufizimeve praktike të rrethanave ekzistuese të atëhershme. Detajet e kësaj mbështetjeje do të përcaktohen në dokumentet rezultuese.

3.5 Dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi aplikohen në kohë paqeje, emergjencash, krize dhe konflikti ose në periudha tensionesh ndërkombëtare, siç mund të përcaktohen reciprokisht nga autoritetet e duhura të vendit pritës dhe NATO-s.

3.6 Ndërsa vendet dërguese nxiten të marrin pjesë në stërvitjet dhe të pranojnë dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi si një dokument gjithëpërfshirës nën të cilin sigurohet mbështetja e vendit pritës, marrëveshje të veçanta bilaterale me shtete individuale mund të merren parasysh nga vendi pritës rast pas rasti.

3.7 Vendi pritës dhe komanda strategjike mund të përcaktojnë përfaqësues për të diskutuar në lidhje me dokumentacionin rezultues që mbështet dhe plotëson këtë MOU.

3.8 Stërvitjet e mbështetura nga ky Memorandum Mirëkuptimi mund të kërkojnë mbështetje shumëkombëshe për operacionet ajrore, përmes avionëve dhe helikopterëve me krahë të fiksuar dhe në rastin e porteve, përmes mjeteve lundruese mbështetëse ushtarake e tregtare. Vendi pritës pranon se lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazheve në dhe përgjatë territorit të tij do të realizohet në bazë të një hapësire të përgjithshme gjatë kohëzgjatjes së operacionit. Vendi pritës do të kontrollojë/administrojë të gjitha aspektet e kësaj hapësire.

3.9 Ky Memorandum Mirëkuptimi ka për qëllim të jetë në harmoni me ligjet e vendit pritës dhe me çdo marrëveshje tjetër ndërkombëtare të zbatueshme.

SEKSIONI 4
DOKUMENTE TË REFERUESHME

Dokumentet e referueshme që mund të zbatohen në këtë Memorandum Mirëkuptimi janë në përmbajtje të shtojcës A.

SEKSIONI 5
PËRGJEGJËSITË

Brenda dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi

5.1 Vendi pritës

a) Gjatë zhvillimit të dokumenteve mbështetëse të këtij MOU dhe sipas ndryshimeve që do të hasen, dhe pas plotësimit të këtyre dokumenteve, vendi pritës do të njoftojë në kohë komandën përkatëse të NATO-s lidhur me disponueshmërinë dhe ndonjë mangësi në kapacitetet e mbështetjes së vendit pritës. Vendi pritës duhet të ketë parasysh se projektet e NATO-s mbështeten në dokumentet e krijuara mbështetëse të kësaj Marrëveshjeje dhe kërkojnë njoftim në kohë për ndryshime të planifikuara në lidhje me krijimin dhe kapacitetin kombëtar.

b) Në mënyrë që të sigurohet mbështetja, vendi pritës do të realizojë përgatitjet e nevojshme me burime mbështetëse, përfshirë burime civile dhe tregtare. Mbështetja tregtare do të sigurohet nëpërmjet një procesi ofertash konkurruese prej ofertës më të ulët.

c) Vendi pritës do të mbajë të dhënat administrative e financiare të nevojshme për rimbursimin e vendit pritës për burimet e siguruara ndaj forcave. Të dhënat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxhetet e NATO-s do t'i jepen NATO-s, kur të kërkohen për qëllim auditimi.

d) Standardi i mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga vendi pritës do të jetë në përputhje me detajet e përcaktuara në dokumentet shtesë mbështetëse.

e) Vendi pritës do të ruajë kontrollin e burimeve të tij mbështetëse, përveç rasteve kur kontrolli i këtyre burimeve është lënë i lirë.

f) Vendi pritës do të sigurojë përpara stërvitjeve, një listë çmimesh për çdo mbështetje përkatëse ose të identifikuar prej tij.

g) Vendi pritës do të ftojë vendet dërguese të pranojnë dispozitat e këtij MOU ose me anë të një note pjesëmarrjeje, ose deklarate qëllimi.

h) Vendi pritës do të sigurojë procedurat për një lidhje mjekësore midis vendit pritës dhe vendeve dërguese, përfshirë pikat e kontaktit mjekësor.

i) Vendi pritës do t'i sigurojë forcave mbështetje mjekësore dhe dentare, nëpërmjet personelit/shërbimeve ushtarake në të njëjtat kushte sikundër personelit ushtarak të vendit pritës.

j) Gjatë realizimit të mbështetjes dhe dokumentacionit rezultues, vendi pritës do të sigurojë për komandantin e NATO-s kopje të çdo rregulloreje që ka të bëjë me bujqësinë, shëndetësinë, shëndetin dhe sigurinë, të cilat mund të aplikohen në stërvitje, si edhe rregulloret që kanë të bëjnë me ruajtjen, lëvizjen ose depozitimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve.

k) Çdo kërkesë për mbështetje shtesë të paparashikuar nga MOU do të diskutohet ndërmjet Palëve ose ndërmjet vendit pritës dhe vendeve dërguese, me synim zgjidhjen e vështirësive logjistike nëpërmjet ekzekutimit të përgatitjeve shtesë për mbështetjen e vendit pritës.

5.2 Komandanti i NATO-s

a) Komandanti i NATO-s do të sigurojë në maksimumin e mundshëm që dokumentet mbështetëse të specifikojnë tipin, masën dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar. Është vërejtur se misioni dhe struktura e forcave nuk mund të specifikohen para hartimit të Planit të Operacionit (OPLAN), Mandatit Operacional (OPORD) ose Rendit Operacional të Stërvitjes. Komanda e NATO-s do të sigurojë informacion shtesë të nevojshëm për planifikimin nga ana e vendit pritës sa më shpejt që të jetë e mundur.

b) Komandanti i NATO-s do të njoftojë në kohë vendin pritës për çdo ndryshim, sipas rrethanave dhe do të propozojë modifikime të dokumenteve rezultues, sipas nevojës.

c) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë nëse financimi i përbashkët është i disponueshëm dhe se cilat kërkesa janë të pranueshme për një financim të tillë.

d) Komandanti i NATO-s do të përcaktojë dhe vendosë prioritete mbi mbështetjen e vendit pritës dhe do të miratojë kuotat e pagesave të përbashkëta.

e) Komandanti i NATO-s do të sigurojë rimbursime financiare për vendin pritës për mbështetjen e vendit pritës të rënë dakord, nëse parashikohet të paguhet nëpërmjet fondit të përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, komandanti i NATO-s do të ndihmojë sa të jetë e mundur në zgjidhjen e detyrimeve financiare mes vendit pritës dhe vendeve dërguese.

f) Nëse kërkesat e vendeve dërguese nuk përputhen me prioritetet e shpërndarjes së burimeve të komandës së NATO-s, komanda përkatëse e NATO-s do të zgjidhë konfliktin me vendet dërguese të përfshira.

g) Komandanti i NATO-s do të identifikojë personelin dhe kërkesat e tjera për vendqëndrimin operacional që do të ngrihet në vendin pritës.

h) Komandanti i NATO-s do të lehtësojë standardizimin e kërkesave dhe pagesave për mbështetje gjatë negociatave dhe/ose në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës.

5.3 Vendet dërguese

a) Vendet dërguese mund të zgjedhin për të marrë pjesë në procedurat dhe strukturat për mbështetjen e vendit pritës, duke pranuar dispozitat e këtij Memorandumi Mirëkuptimi nëpërmjet një note pjesëmarrjeje dhe/ose deklaratës së qëllimit.

b) Vendet dërguese do të identifikojnë kërkesat e mbështetjes të vendit pritës dhe komandantit përgjegjës të NATO-s.

c) Për kërkesat e kostos së drejtpërdrejtë kombëtare, vendet dërguese do të marrin pjesë në negociata për mbështetjen e vendit pritës gjatë takimit të komitetit drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës ose direkt me vendin pritës, nëse komiteti drejtues i përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës nuk është krijuar ende. Vendet e pritjes do të sigurojnë pagesë direkte ose rimbursojnë mbështetjen vendit pritës vetëm për shërbimet e siguruara nga burime ushtarake, me përjashtim të rasteve kur procedura të tjera përdoren siç është rënë dakord. Sipas marrëveshjeve kontraktuale të bëra ndërmjet vendit pritës dhe vendeve dërguese, mbështetja e siguruar nga burimet private ose civile do të paguhet drejtpërdrejt nga vendet dërguese.

d) Vendet dërguese do të sigurojnë një personel të autorizuar për të marrë pjesë në bisedimet me vendin pritës në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës, nëse ekziston.

e) Vendet dërguese do të raportojnë ndryshimet në kërkesat e mbështetjes së vendit pritës dhe komandantit përkatës të NATO-s, kur ato ndodhin dhe paraqesin kërkesat e rishikuara dhe/ose raportet për statusin.

f) Vendet dërguese janë përgjegjëse për koston e çdo shërbimi mjekësor dhe dentar civil të siguruar nga vendi pritës.

g) Vendet dërguese duhet të ndjekin rregulloret dhe procedurat mbi bujqësinë, ambientin, sigurinë, dhe shëndetin e vendit pritës, të përcaktuara për vendqëndrimet operacionale, si dhe çdo rregullore të vendit pritës mbi ruajtjen, zhvendosjen ose asgjësimin e materialeve të rrezikshme.

SEKSIONI 6
DISPOZITA FINANCIARE

6.1 Në bazë të marrëveshjeve dhe/ose konventave ndërkombëtare të ndërsjella, aktivitetet e shtabeve ndërkombëtare, vendqëndrimet operacionale, mjetet në pronësi dhe/ose në zotërim nga NATO, avionët, automjetet, POL dhe forcat të cilat i sigurohen NATO-s, do të jenë të përjashtuara nga të gjitha taksat, detyrimet, tarifat e shtetit dhe detyrime të tjera të ngjashme me to.

6.2 Protokolli i Parisit dhe Protokolli i Mëtejshëm Shtesë, i cili zbaton imunitete dhe privilegje për shtabet e NATO-s, do të aplikohet për çdo shtab ndërkombëtar, njësitë dhe detashmentet e të cilëve mund të dislokohen në vendin pritës për qëllim të stërvitjes.

6.3 Atëherë kur nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet, tarifat dhe detyrime të tjera, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për forcat e armatosura të vendit pritës. Të gjitha shpenzimet duhet të kryhen me vlerën më të vogël të kërkesave administrative shoqëruese.

6.4 Transaksionet financiare, në mënyrë që të përfshijnë transferimin e fondeve dhe krijimin e llogarive bankare në çdo bankë private ose shtetërore, duhet të zhvillohen të përjashtuara nga detyrimet dhe tarifat e çdo lloji.

6.5 Rregullimet përfundimtare financiare, në mënyrë të veçantë ato që lidhen me fondin e përbashkët të NATO-s, mundësisht do të përcaktohen vetëm para implementimit të stërvitjeve. Megjithatë, të gjitha negociatat financiare të bëra paraprakisht, duhet të bëhen specifike sipas detyrimeve financiare maksimale të NATO-s. Shpenzimet e paspecifikuara si shpenzime nga buxheti i NATO-s, para se të shkaktohen, nuk do të përfshihen në fondin e përbashkët të NATO-s.

6.6 Dokumentet pasuese do të sigurojnë bazën fillestare për vlerësimet e kostos dhe do të shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve ose si shpenzime të përbashkëta të NATO-s (nëse është e zbatueshme), shpenzime të përbashkëta ose shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta.

6.7 Nëse komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime të caktuara janë si të pranueshme, ashtu edhe të përballueshme për fondin e përbashkët të NATO-s (nga akordimet e miratuara të buxhetit), komanda strategjike do të autorizojë financim të përbashkët për ato shpenzime dhe ose do t'i paguajë drejtpërsëdrejti ose ta rimbursojë vendin pritës.

6.8 Nëse disa shpenzime janë parashikuar t'i atribuohen më shumë se një vendi, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të përbashkëta dhe me marrëveshje të vendeve të përfshira, mund të ndahen në përputhje me një formulë për ndarjen e shpenzimeve të miratuara në marrëveshjen teknike ose në dokumente të tjera mbështetëse.

6.9 Për kërkesat e kostos së drejtpërdrejtë kombëtare, vendi dërgues normalisht do të marrë pjesë në negociata për mbështetjen e vendit pritës në komitetin drejtues të përbashkët mbi mbështetjen e vendit pritës ose drejtpërdrejt me vendin pritës, nëse komiteti nuk është krijuar ende. Vendet dërguese do të sigurojnë pagesë të drejtpërdrejtë ose rimbursim për mbështetjen e vendit pritës, vetëm për shërbime të siguruara nga burime ushtarake, me përjashtim të rasteve kur procedura të tjera pagese përdoren, siç është rënë dakord. Sipas marrëveshjeve kontraktuale mes vendit pritës dhe vendeve dërguese, mbështetja e siguruar prej burimeve civile dhe tregtare do të paguhet direkt nga vendet dërguese.

6.10 Detyrimet për materialet dhe shërbimet civile dhe ushtarake të siguruara nga vendi pritës nuk do të shlyhen në një shkallë më të lartë se shlyerja për forcat e armatosura të vendit pritës dhe nuk do të përfshijnë shpenzime shtesë administrative ose shpenzime të tepërta, por mund të reflektojnë rregullime për shkak të programit të shpërndarjes, pikave të shpërndarjes ose elementeve të ngjashme. Rimbursimi nuk do të paguhet për mbështetjen e siguruar nga personeli ushtarak.

6.11 Komandanti i NATO-s dhe vendet dërguese mund të kontraktojnë drejtpërdrejt me ofertues tregtarë për oferta, shërbime dhe nevoja te tjera.

6.12 Automjetet në pronësi të NATO-s dhe automjetet ushtarake të vendeve dërguese janë të vetësiguruara dhe si të tilla mund të veprojnë pa siguracion tregtar brenda territorit të vendit pritës.

6.13 Vendi pritës nuk shkakton detyrime financiare në emër të komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese, përveç rasteve kur i kërkohet specifikisht ta bëjë këtë më përpara nga një përfaqësues i autorizuar dhe në rastet kur është pranuar përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk do të livrohet derisa komanda strategjike ose vendet dërguese, sipas nevojës, të miratojnë dokumentet mbështetëse përkatëse dhe të drejtojnë implementimin e tyre.

6.14 Financimi nuk jepet në lidhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi dhe ky dokument nuk përfaqëson një detyrim specifik financimi nga ana e komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese.

Marrëveshje të veçanta financiare dhe procedura rimbursimi do të specifikohen në dokumentet pasuese.

6.15 Vendosja e zonave operacionale për të mbështetur një operacion të NATO-s nuk parashikon ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës.

SEKSIONI 7
DISPOZITA LIGJORE

7.1 Komandat strategjike do të ekzekutojnë ose mund të delegojnë veprime ligjore thelbësore për realizimin e misioneve, përfshirë këtu, por jo kufizuar me ushtrimin e së drejtës për të kontraktuar, për t'u përfshirë në procese ligjore ose administrative dhe për të përfituar e shfrytëzuar pasuri.

7.2 Statusi i forcave të dislokuara në territorin e vendit pritës do të përcaktohet në përputhje me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe/ose Protokollin e Mëtejshëm Shtesë.

7.3 Pajisjet, furnizimet, prodhimet dhe materialet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i vendit pritës në lidhje me stërvitjen, janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifat. Procedura të tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me NATO-n ose PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe Protokollin e Mëtejshëm Shtesë, si të jetë e zbatueshme.

7.4 Pretendimet jokontraktuale që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi të natyrës së nenit 7 të NATO SOFA-s, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit të lartpërmendur.

7.5 Pretendimet kontraktuale do të shqyrtohen dhe zgjidhen nga vendi pritës, përmes procesit që drejton kontratat publike dhe në përputhje me ligjet e vendit pritës, me rimbursim nga komandanti i NATO-s ose vendet dërguese.

7.6 Anëtarët e Forcës do të kenë me vete këto dokumente kur hyjnë ose kalojnë kufijtë e vendit pritës dhe do t'i paraqesin ato kur iu kërkohet:

- Karta ushtarake e identitetit kombëtare/e NATO-s.
- Urdhri individual ose kolektiv i udhëtimit i NATO/PfP.

Vendi pritës do të pranojë këto dokumente si dokumente të rregullta për hyrjen në pikat e kalimit kufitar nga anëtarët e Forcës, pa ndonjë kërkesë shtesë.

SEKSIONI 8
MBROJTJA E FORCËS

8.1 Një mbrojtje e plotë dhe efektive e Forcës do të planifikohet për qëllim të stërvitjeve dhe do të detajohet në marrëveshjet OPLANS, EXPI ose marrëveshjet shtesë, sipas nevojës. Mbrojtja e Forcës do të zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s, dhe në mënyrë të pajtueshme me NATO-n ose PfP-SOFA. Mbrojtja e Forcës në asnjë mënyrë nuk do të kërkohet ose sigurohet në kundërshtim me ligjet e NATO-s/PfP/SOFA ose ligjet e vendit pritës.

8.2 Sipas rastit, vendi pritës do të informojë vendin dërgues dhe komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara të mbrojtjes së Forcës.

8.3 Sipas rastit, secili vend dërgues është përgjegjës për identifikimin dhe sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së Forcës, vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

8.4 Përveç përgjegjësive të mbrojtjes së Forcës, të përcaktuara në politikën dhe procedurat e NATO-s, komandanti i NATO-s është përgjegjës për koordinimin e mbrojtjes së Forcës së kërkuar dhe të siguruar nga vendi pritës dhe vendet dërguese, sipas nevojës për mbrojtjen e Forcës.

SEKSIONI 9

9.1 Pjesëmarrësit dhe vendet dërguese do t'i konfirmojnë NATO-s procedurat ekzistente të sigurisë, përdorimin, transmetimin dhe ruajtjen e të gjithë informacionit të klasifikuar, që mbahet, përdoret, krijohet, sigurohet ose shkëmbehet.

9.2 Informacioni i siguruar një tjetri nga ana e një pjesëmarrësi ose vendi dërgues në konfidencë dhe informacion të tillë të siguruar nga çdo pjesëmarrës ose vend dërgues që kërkon fshehtësi, ose do të mbajë klasifikimin e tij fillestar ose do t'i caktohet një nivel klasifikimi që do t'i sigurojë një shkallë mbrojtjeje kundër zbulimit, të njëjtë me atë që kërkohet nga pjesëmarrësi tjetër ose vendi dërgues.

9.3 Secili pjesëmarrës dhe vend dërgues do të ndërmarrë hapa ligjorë të disponueshëm për të mbrojtur nga zbulimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në konfidencë, përveçse kur pjesëmarrësit e tjerë dhe/ose vendet dërguese e miratojnë një zbulim të tillë.

9.4 Për të ndihmuar në sigurimin e mbrojtjes së kërkuar, secili pjesëmarrës ose vend dërgues do të shënojë informacionin e dhënë tjetrit në konfidencë me një legjendë që tregon origjinën e tij, klasifikimin e sigurisë, kushtet e publikimit, që ky informacion ka lidhje me një operacion specifik të NATO-s dhe se ai është siguruar në konfidencë.

9.5 Vizita nga ana e personelit do të kryhet në përputhje me procedurat e specifikuara në C-M (2002) 49, sipas ndryshimeve.

SEKSIONI 10
FILLIMI, KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

10.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën kur komandanti i NATO-s merr njoftimin me shkrim nga vendi pritës për përmbushjen e të gjitha procedurave të nevojshme për hyrjen në fuqi të MOU-t. Ky Memorandum do të mbetet në fuqi deri në largimin e plotë të forcave. Komanda e NATO-s do të njoftojë vendin pritës kur largimi i plotë të jetë kryer.

10.2 Të gjitha dispozitat e seksionit 6, 7 dhe 9 do të mbeten në fuqi, në rast të tërheqjes së ndonjë pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij Memorandumi Mirëkuptimi, deri në përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Vendet dërguese do të përmbushin të gjitha detyrimet në rast të çdo përfundimi ose tërheqjeje.

SEKSIONI 11
NDRYSHIMET, INTERPRETIMI DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

11.1 Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të modifikohet ose ndryshohet me shkrim, me pëlqim të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve.

11.2 Çdo konflikt për interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet me konsultim mes palëve në nivelin me të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet për zgjidhje një gjykate kombëtare ose ndërkombëtare ose një pale të tretë për zgjidhje.

11.3 Ky Memorandum Mirëkuptimi është firmosur në tri kopje, secila në gjuhën shqipe dhe angleze.

11.4 Problemet e përkthimit ose të interpretimit të këtij MOU do të zgjidhen sipas variantit të gjuhës angleze. Memorandumi paraprirës paraqet mirëkuptimin e plotë mbi çështjet e referuara në këtë dokument, të arritur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shtabit Suprem të Forcave Aleate të Europës të përfaqësuara nga Shtabi i Komandës së Divizionit Aleat Tokësor Heidelberg.

NËNSHKRUAR:
Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë
Petrit Karabina
Zëvendësministër i MOD-it

Në emër të Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE)
Carsten Svensson
Major General, DA Army
Chief of Staff
Shtabi i Komandës së Divizionit Aleat Tokësor Heidelberg

SHTOJCA A E MOU-T

Dokumentet e referimit

a) Traktati i Atlantikut të Veriut më 4 prill 1949.

b) Dokumenti Bazë i Partneritetit për Paqe, i lëshuar nga kryetarët e shteteve dhe vendet pjesëmarrëse në Mbledhjen e Këshillit të Atlantikut Verior më 10 janar të vitit 1994.

c) Marrëveshja ndërmjet Palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut
Lidhur me Statusin e Forcave të tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1951.

d) Marrëveshja ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe lidhur me Statusin e Forcave të Tyre (NATO SOFA), të datës 19 qershor 1995.

e) Protokolli Shtesë i Mëtejshëm i Marrëveshjes midis Shteteve Palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe lidhur me Statusin e Forcave të Tyre, 19 dhjetor 1997.

f) Protokolli për Statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në vijim të Traktatit të

Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit), datë 28 gusht 1952.

g) MC 319/1- Parimet dhe Politikat Logjistike të NATO-s.

h) MC 334/1- Parimet dhe Politikat e NATO-s për Mbështetjen e Vendit Pritës.

i) STANAG-et e aplikueshme të NATO-s dhe Direktivat Orientuese për Mbështetjen Logjistike, Mbrojtjen e Forcave dhe Rimbursimi Financiar.

j) AJP-4.5 (A)-Publikimet e Përbashkëta të Aleancës në lidhje me Doktrinat dhe Procedurat e Mbështetjes së Vendit Pritës.

k) CM(2002)50-Masat Mbrojtëse për Trupat Civile dhe Ushtarake të NATO-s, Dislokimi i Forcave dhe Bazave Ushtarake të NATO-s (Asetet) kundër Kërcënimeve Terroriste.

l) BI-SC Direktivat e Mbrojtjtes së Forcave 80-25, 1 janar 2003

m) BI-SC Guida e Planifikimit Veprues për Mbrojtjen e Forcave.

n) AAP-6-Fjalori i Terminologjisë.

o) C-M (2002) 49, Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.